

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7904
E premte, 11 tetor 2024
Çmimi 0.50

Erdogani i premton Shqipërisë dronë kamikazë



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

BISEDA E KUSARIT ME RADOJIÇIQIN PËRPLASI PUSHTETIN DHE OPOZITËN NË KUVEND

MIMOZA KUSARI MIDIS KUVENDIT RRETHOHET ME SHIRITIN QË MBAN MBISHKRIMIN 'RREZIK'



Shefja e grupit parlamentar e LV-së, Mimoza Kusari-Lila, të enjten nuk e ka pasur një ditë të lehtë. Në seancën parlamentare ajo është injoruar nga deputetët e LV-së. Ndonëse në sallë ishin 60 deputetë të mazhorancës, askush

prej tyre nuk i ka dalë në mbrojtje Kusari-Lilës, e cila, si asnjëherë më parë, ishte në thumb të kritikave të opozitës për bisedën e saj me Milan Radojiçiqin, e cila është publikuar një ditë më parë në "Paparaci". Ajo është

nervozuar edhe më shumë kur deputeti i pavarur i Kuvendit, Haki Abazi, i ka mbështjellë me shirit, në të cilin shkruhej 'Danger' - 'Rrezik', mikrofonin dhe foltoren e Kuvendit derisa ajo fliste

AKTUALE



UNICEF-i: MË SHUMË SE 370 MILIONË VAJZA JANË VIKTIMA TË DHUNËS SEKSUALE F. 2

POLICIA DHE DOGANA PARANDALONJË TRI RASTE TË KONTRABANDËS SË MALLRAVE F. 7

SKANERËT NË PIKAT KUFITARE: KUR, SI DHE PSE? F. 5


EKONOMI



CEFTA MIRATON 9 MARRËVESHJE TË REJA PËR TA NXITUR TREGTINË, PUNËSIMIN DHE TË DREJTAT E KONSUMATORIT NË TË GJITHË RAJONIN F. 8

RAMA TAKON PËRFAQËSUESIT E BIZNESEVE: BIZNESET JANË SHTYLLA E ZHVILLIMIT EKONOMIK PRISHTINËS F. 8

SPORT



KOSOVA NISËT DREJT LITUANISË, RRAMANI DHE RRUDHANI PARALAJMËROJNË FITORE F. 10

25-VJETORI I THEMELIMIT TË PDK-së, KRASNIOI PRET NË TAKIM BASHKËSHORTEN E THAÇIT E TË VESELIT F. 7



REAGIM I KMDLNJ-së: PSE ISHTE TRANDAFILOVA NË PRISHTINË? F. 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

UNICEF: Më shumë se 370 milionë vajza janë viktima të dhunës seksuale

NJU-JORK, 10 TETOR - Më shumë se 370 milionë vajza dhe gra të reja nën moshën 18-vjeçare janë dhunuar apo janë sulmuar seksualisht në gjithë botën, sipas Agjencisë së Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF). Këto janë shifrat e para të agjencisë lidhur me dhunën seksuale ndaj fëmijëve, në nivel global, dhe janë publikuar një ditë para shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Vajzave. Të dhënat nënkuptojnë që një në tetë vajza është e prekur nga kjo formë e dhunës, raporton REL. Nëse në të dhëna përfshihen edhe format e tjera të dhunës seksuale, sikurse ato që kryhen online apo dhuna verbale, atëherë numri do të shkonte në mbi 650 milionë, që do të thotë se çdo e pesta vajzë është përballur

me një formë dhune, ka thënë UNICEF.

Situata është më e komplikuar në rajonet më të cenueshme, sikurse ato me institucione më të dobëta, me prani të forcave paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara, apo me prani të shumë refugjatëve që i ikin dhunës dhe pasigurive.

Në këto situata shkalla e dhunimeve dhe sulmeve seksuale mund të rritet në më shumë se çdo të katërtën vajzë.

Edhe djemtë dhe burrat e rinj preken nga dhuna seksuale, ka raportuar agjencia.

Vlerësohet që rreth 240 deri në 310 milionë djem - rreth një në 11 - kanë përjetuar dhunë apo sulme seksuale gjatë fëmijërisë. Sipas të dhënave, rastet më të shpeshta të dhunës seksuale ndodhin gjatë adoleshencës.



Rajonet me numrin më të madh të rasteve të dhunës seksuale të fëmijët janë: Afrika sub-Sahariane, më pas Azia Lindore

dhe Juglindore, Azia Qendrore dhe Jugore dhe më pas Evropa dhe Amerika Veriore. Raporti është përpiluar pas

kryerjes së anketave në më shumë se 120 shtete dhe territore në periudhën 2010-2022, ka thënë UNICEF.

BE-ja i ofron Moldavisë ndihmë financiare në vlerë rreth 2 miliardë euro

Kishinjev, 10 tetor - Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, u ka bërë thirrje moldavëve të votojnë në dy palë zgjedhjet vendimtare të këtij viti dhe njoftoi se Bashkimi Evropian do ta ndihmojë me 1.8 miliard euro ekonominë e Moldavisë në tre vjetët e ardhshëm.

Presidentja prorektorë e Moldavisë, Maia Sandu, po garon për mandatin e dytë në zgjedhjet e 20 tetorit, gjatë të cilave moldavët do ta thonë fjalën e tyre nëse duan t'i bashkohen BE-së.

Von der Leyen, e cila e vizitoi Moldavinë më 10 tetor, në shenjë mbështetjeje për synimet e saj evropiane, inkurajoi moldavët në një konferencë të përbashkët për shtyp me Sandun, që të dalin dhe të votojnë për ta shprehur "zgjedhjen e tyre të lirë dhe sovranë", por u përmbajt duke mos u thënë se si të votonin. Nën drejtimin e Sandut - e cila u



arsimua në Shtetet e Bashkuara dhe erdhi në pushtet pasi e mundi Igor Dodonin, të mbështetur nga Rusia, në vitin 2020 - Moldavia ndryshoi rrugën drejt Perëndimit, duke dënuar pushtimin e paprovokuar të Ukrainës nga

Moska dhe duke iu bashkuar regjimit të sanksioneve të BE-së kundër Kremlinit.

Moldavia e mori statusin e vendit kandidat për anëtarësim në BE në qershor të vitit 2022 dhe hapi negociatat për anëtarësim me

blokun në fillim të këtij viti. Këta hapa nxitën Rusinë t'i shtonte përpjekjet për ta minuar besueshmërinë në Qeverinë e Moldavisë dhe për ta paraqitur Moskën si një alternativë më të mirë për të ardhmen e Kishinjevit. Von der Leyen tha se "vendit i Moldavisë është në Bashkimin Evropian, dhe se anëtarësimi në bllok mund të kontribuojë në "dyfishimin e ekonomisë së vendit në 10 vjetët e ardhshme".

Ajo tha se paketa prej 1.8 miliard eurosh do të përdoret për të investuar në "zonat që do të gjenerojnë rritje ekonomike dhe shërbime publike", si riparimi i shkollave, ndërtimi i dy spitaleve të reja në qytetet Balti dhe Cahul, ndërtimi i rrugëve dhe urave për ta lidhur Moldavinë me fqinjët e saj, gjithashtu edhe zhvillimi i rrjetit energjetik të vendit.

Këto palë zgjedhje shihen si vendimtare për të ardhmen e

Moldavisë, një vend me 2.5 milionë banorë që shtrihet midis Rumanisë dhe Ukrainës, ku Rusia vazhdon të ushtrojë ndikim të madh dhe mban më shumë se 1 000 trupa në rajonin separatist të Transdnestr, 33 vjet pas pavarësisht të Moldavisë nga Bashkimi Sovjetik.

Von der Leyen vlerësoi Sandun për "përkushtimin e madh" të saj për "rrugën evropiane të Moldavisë" dhe për përparimet që ka bërë Moldavia drejt anëtarësisht në BE, duke përmendur "nisjen e reformave në drejtësi, luftën kundër korrupsionit dhe përjashtimin e oligarkëve nga sektori ekonomik".

Sandu e quajti ndihmën financiare të BE-së "simbol të besimit në potencialin e Moldavisë për zhvillim". "Faleminderit, e dashura Ursula, për ndihmën tuaj për Moldavinë gjatë gjithë këtyre viteve", tha Sandu.

Zelensky nis turne evropian për ta rritur mbështetjen para dimrit

LONDËR, 10 TETOR - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky pritet të nisë një turne në kryeqytetet e aleateve evropiane, teksa synon të sigurojë më shumë mbështetje financiare dhe ushtarake për Ukrainën. Ndërkohë, vendi i tij vazhdon të përballet me sulme ditore prej Rusisë dhe me një ofensivë ruse në lindje, që po shënon përparim.

Zelensky do ta nisë udhëtimin të enjten në Londër, ku do të takohet me kryeministrin

britanik Keir Starmer dhe sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte. Këto takime do të zhvillohen një ditë pasi samiti i mbështetësve të Ukrainës në bazën Ramstein është anuluar pak para se të niste.

Zyra për media e Zelenskyt ka thënë se ai do t'i nisë negociatat "me partnerët kyç, nga të cilët varet forca jonë".

Një zëdhënës i Starmerit u ka thënë gazetarëve se kryeministri do ta "ritheksojë mbështetjen e palëkundur për Ukrainën teksa

përballet me agresionin rus".

Lideri ukrainas pritet të zhvillojë takime edhe në Paris, me presidentin e Francës, Emmanuel Macron, më pas do të udhëtojë në Romë, për t'u takuar me kryeministren italiane Georgia Meloni, me Papa Françeskun në Vatikan, dhe me kancelarin gjerman Olaf Scholz në Berlin. Zelensky i ka sytë edhe te Shtetet e Bashkuara, prej ku synon të fitojë sa më shumë përkrahje, para zgjedhjeve presidenciale, që do të mbahen në nëntor.



Erdogani i premtun Shqipërisë dronë kamikazë

Gjatë konferencës për medie me presidentin turk Recep Tayyip Erdogan, kryeministri Edi Rama njoftoi se Shqipëria do të marrë dronë kamikazë për ushtrinë, si një dhuratë që i vjen nga Turqia. Kryeministri Rama u shpreh se çmon dhuratën e presidentit turk, ndërsa theksoi se kjo dhuratë “nuk duhet ta shqetësojë askënd se kë do të godasë Shqipëria”

TIRANË, 10 TETOR - Turqia do t'ia dhurojë Shqipërisë një numër të “konsiderueshëm” të dronëve kamikazë, tha kryeministri shqiptar Edi Rama pas vizitës së presidentit turk Recep Tayyip Erdogan të enjten në Tiranë. “Dhuratë që s’duhet ta shqetësojë askënd, se kë do të godasë Shqipëria, por besoj se është një dhuratë që përmbledh brenda një mesazh të qartë të Turisë në raport me këtë marrëdhënie, që Shqipëria është e pagoditshme”, tha Rama në një konferencë të përbashkët për shtyp me Erdoganin.

As Rama e as Erdogani nuk treguan sa dronë saktësisht do t'ia dhurojë Turqia aleates së vet në NATO.

Erdogani, ndërkohë, tha se, përveç mbështetjes në pajisje ushtarake, Turqia do ta ndihmojë ushtrinë shqiptare edhe me trajnime ushtarake.

Lideri turk, i cili u prit me ceremoni zyrtare nga presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, në kryeqytetin shqiptar, tha se synon që vëllimin tregtar me Shqipërinë ta rrisë në 2 miliardë dollarë.

Turqia është ndër investitorët më të mëdha në Shqipëri me rreth 3.7 miliardë euro, ndërsa më shumë se 15 mijë shqiptarë janë të punësuar nga 830 kompanitë turke që operojnë në Shqipëri. “I shohim nismat në fushën e tregtisë dhe investimeve si hapa që do ta rrisin mirëqenien e popujve. Ramë dakord t’i diversifikojmë investimet e ndërsjella duke përfshirë sektorë novatorë”, tha Erdogan.

Rama deklaroi se u pajtua me Erdoganin për më shumë investime të drejtpërdrejta nga ana turke në sektorin e turizmit në Shqipëri. “Sot firmosëm disa marrëveshje. Më e mirëpritura është firmosja e marrëveshjes për



Universitetin Teknik të Stambollit në Tiranë. Jemi shumë të interesuar dhe shumë të përmbushur sot në fuqizimin e ushtrisë së Shqipërisë dhe fuqizimin e kësaj marrëdhënieje në aspektin ushtarak”, tha Rama. Zyra e kryeministrit Rama njoftoi më herët se dy vendet nënshkruan tri marrëveshje gjatë një takimi të Këshillit të Bashkëpunimit të nivelit të lartë Shqipëri - Turqi.

Një deklaratë të synimit mbi bashkëpunimin në fushën e sigurimeve në bujqësi, të

mbështetur nga shteti, midis Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Shqipërisë dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë të Turqisë.

Një protokoll ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Shqipërisë dhe Këshillit të Lartë të Arsimit të Turqisë për Hapjen e Degës, Njesisë Akademike, Programeve të Studimit nga Universiteti Teknik i Stambollit në Shqipëri.

Një Memorandum të Mirëkuptimit ndërmjet Agjencisë për Media dhe Informim të

Shqipërisë dhe Drejtorisë së Komunikimit të Presidencës së Turqisë për bashkëpunim në fushën e marrëdhënieve me publikun dhe komunikimin.

Marrëveshja për deklaratën mbi bashkëpunimin në fushën e sigurimeve në bujqësi “shënon një etapë të re në forcimin e marrëdhënieve dypalëshe në këtë fushë”, tha zyra e Ramës.

Më 2021 këto dy vende e nënshkruan një marrëveshje për krijimin e Këshillit të Bashkëpunimit të nivelit të lartë Shqipëri - Turqi, ndërsa mbledhja e parë u mbajt në shkurt të këtij viti.

Në Ankara, gjatë vizitës së kryeministrit Edi Rama atje më 20 shkurt, u nënshkruan gjashtë marrëveshje dhe memorandume mirëkuptimi në fushën e mjedisit, bujqësisë, medias dhe ushtarake.

Prej ardhjes në pushtet të Partisë Socialiste, kryeministri Rama e ka cilësuar Turqinë partnere strategjike dhe ka deklaruar se bashkëpunimi ndërmjet dy vendeve do të arrijë në nivele të panjohura më parë.

Gjatë vizitës së tij në Tiranë Erdogani mori pjesë edhe në përrurimin e xhamisë së Namazgjasë.

Në lidhje me përrurimin e saj, Erdogani tha në konferencë se xhamia “është dhuratë e popullit turk për vëllezërit dhe motrat shqiptare”. “Ajo është xhamia më e madhe në Ballkan dhe do të jetë vendi ku do të lulëzojë ndenja e

paqes dhe solidaritetit”, tha Erdogani.

Në këtë ceremoni të rëndësishme për besimtarët myslimanë nuk mori pjesë kreu i Komunitetit Mysliman Shqiptar, Bujar Spahiu, as drejtues të tjerë. Komuniteti u përfaqësua nga myftiu i Tiranës, Gazmend Teqja, i cili do ta drejtojë xhaminë e Namazgjasë.

Në shtator të këtij viti u bë publike në media një letër e KMSH-së, ku theksohej se ky institucion jep pajtimin që Xhamia e Namazgjasë të administrohet nëpërmjet një fondacioni, i cili do të jetë “autoriteti i vetëm në këtë aspekt” dhe do të ketë si qëllim të veçantë të tij “marrjen përsipër të menaxhimit, administrimit, funksionimit dhe përdorimit pa afat të xhamisë, si dhe të kompleksit përreth saj”.

Ndërtimi i xhamisë nisi në vitin 2015 dhe themeli u vendos nga presidenti turk Erdogan. Ai pati deklaruar në atë kohë se organizata FETO ka strukturat e saj edhe në Shqipëri, dhe se u kishte kërkuar krerëve të institucioneve “eliminimin” e tyre. Punimet u tha se do të përfundonin për tre vjet, por u deshën rreth nëntë vjet që xhamia të përurohet.

Xhamia e Namazgjasë ka një sipërfaqe prej 10 000 metrash katrorë dhe ka kapacitet për 5 000 besimtarë. Pjesë e saj janë edhe bibliotekat, qendra kulturore, parkingu, kursi i librit të shenjtë, Kuranit, salla e ekspozitave, mensa, salla e konferencave etj.





Skanerët në pikat kufitare: Kur, si dhe pse?

Kryeministri Albin Kurti kërkon që qysh prej qershorit Kosova të pajisjet me skanerë në pikat kufitare për ta rritur sigurinë në tregti dhe kufij. Kur do të mund t'i sigurojë Kosova këto pajisje dhe si do t'i shërbejnë ato?

PRISHTINË, 10 TETOR - Kur kryeministri i Kosovës bëri me dije këtë javë se kufizimi ndaj importit të mallrave nga Serbia do të zëvendësohet me kontroll të shtuar në pikën kufitare në Merdar, dhe paralajmëroi instalimin e pajisjeve të skanimit, një pjesë të audiencës mund t'i jetë kujtuar një vizitë e Albin Kurtit në Hamburg këtë vit. Atje ai u informua hollësisht se si Gjermania e ruan sigurinë e vet, duke analizuar secilin mall që i hyn në territor. Vetë autoritetet gjermane ofruan ndihmë që edhe Kosova ta avancojë kontrollin në atë nivel.

Oferta e Gjermanisë për skanerë të avancuar pasoi me kërkesën bërë Qeverisë së Kosovës që ta hiqte kufizimin ndaj mallrave të Serbisë, me argumentin se po shkelte Marrëveshjen për Tregti të Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) dhe se po rrezikonte pjesëmarrjen në nismat rajonale. Me heqjen e kufizimit në Merdar u zhbllkua puna e CEFTA-s.

Pse bllokadë ndaj mallrave nga Serbia?

Masat kufizuese u vendosën në qershor të vitit 2023, pas

arrestimit të tre policëve të Kosovës nga autoritetet serbe. Zyrtarët policorë u liruan ndërkohë, por masa mbeti në fuqi. Ndonëse qëndroi për më shumë se një vit, autoritetet e Kosovës nuk dolën asnjëherë me ndonjë raport vlerësues si ka ndikuar masa në nivelin e sigurisë. "Kosova nuk ka masa tregtare ndaj Serbisë. Kosova ka masa të sigurisë për shkak se për dy vjet na e kanë sjellë ushtrinë katër herë afër kufirit, dhe për shkak se katër herë kemi konfiskuar sasi të jashtëzakonshme të armatimit", u ka thënë Kurti medieve.

Këshilltari i tij, Jeton Zulfaj, i ka thënë Radios Evropa e Lirë se Ministria e Financave dhe Dogana e Kosovës do t'i nisin procedurat e prokurimit për të paktën një skaner, tani për tani, dhe se prioritet është pika e kalimit kufitar në Merdar. "Është masë shumë e rëndësishme, sepse aty vërehet se çfarë po importohet. Nuk mund të kalohet asgjë pa u vërejtur në skanerë. Është e vështirë, pastaj, që të kontrabandohen armë, siç është bërë në të kaluarën. Ky është qëllimi, rritja e nivelit të sigurisë në mallra". Sipas Zulfajt, nga

sigurimi i skanerëve tjerë do të varet hapja e pikëkalimeve të tjera për mallrat nga Serbia.

Si do të duken këto pajisje skanimit?

Pajisjet e skanimit patjetër se do të jenë të teknologjisë tredimensionale (3D). Nuk dihet ende nëse do të jenë statike apo mobile - për këtë pritet të vendosin doganierët, varësisht prej vlugut të qarkullimit në një pikëkalim.

Skanerët statikë montohen afër kufirit, apo në zonë të caktuar, dhe bëjnë skanim të hollësishëm të kamionëve të mëdhenj. Më pas doganierët kanë në kohë reale pamje 3D të brendësisë së produktit dhe brenda kamionit. Çmimi i një skaneri të tillë nuk dihet, por Zulfaj ka thënë se do të përzgjidhen ata që janë të pranueshëm edhe për Bashkimin Evropian. Nuk dihet as sa është buxheti që ka ndarë Kosova për blerjen e tyre.

A duhet që çdo mall të kalojë nëpër skanerë?

Zulfaj ka thënë se për këtë do të

vendosin zyrtarët e Doganës pas trajnimeve profesionale që do t'i kenë për përdorimin e tyre. Gjermania veçse ka ofruar ndihmë për aftësimin e tyre. Dogana e Kosovës nuk ka qenë e qasshme pavarësisht prej përpjekjeve të Radios Evropa e Lirë për të kuptuar më shumë në këtë drejtim.

Ndihma nga Perëndimi

Kurti dhe zyrtarë të tjerë të Kosovës kanë thënë se Gjermania, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe BE-ja i kanë premtuar ndihmë Kosovës për sigurimin e skanerëve.

Zulfaj ka thënë se autoritetet janë në komunikime të vazhdueshme me Gjermaninë.

Drejtori për Komunikime në Ambasadën e Gjermanisë në Kosovë, Christian Bottcher, i ka thënë REL-it se vendi i tij është i gatshëm t'i ndihmojë Kosovës, dhe që skanerët mund të sigurohen pas vlerësimit të nevojave dhe në përputhje me rregullat dhe procedurat e prokurimit publik.

"Kontrolle hermetike"

Drejtori i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) ka thënë për REL-in se është shumë me rëndësi që Kosova "të ketë kufij të kontrolluar hermetikisht". "Siç është parë edhe në incidentin e Banjskës, ka interes

që të futen qoftë armë, qoftë individë, të cilët kanë për qëllim destabilizimin e Kosovës", ka thënë Mentor Vrajolli, duke përmendur edhe nevojën e kontrollimit të rreptë të të gjitha vijave kufitare dhe jo vetëm të pikëkalimeve.

Përfitimet e tjera përveç rritjes së sigurisë?

Mungesa e një skaneri, kur ekziston nevoja për kontrolle të hollësishme, siç po kryhen tani në Merdar, vërehet lehtësisht. Disa tregtarë u kanë thënë medieve se kanë pritur me orë të tëra derisa kanë finalizuar të gjitha procedurat në kufi dhe në Doganë. Vonësia, pastaj, ka efekt zinxhir.

Tregtarët në veri të Kosovës kanë thënë se si pasojë e pritjeve dhe distancës në mes të Merdarit dhe dyqaneve të tyre, ata nuk do të kenë shumë leverdi nga mallrat serbe.

Tregtarët në jug të Ibrit e kanë mirëpritur heqjen e kufizimit, duke thënë se "tradicionalisht ka kërkesë për mallrat nga Serbia". Ndër vite produktet nga Serbia kanë qenë ndër më të shiturat në tregun e Kosovës.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, gjatë vitit 2022 Kosova ka importuar mallra nga Serbia në vlerë prej mbi 372 milionë eurosh, ndërsa në vitin 2023 shifra ka rënë në rreth 199 milionë euro.

BISEDA E KUSARIT ME RADOJIÇIQIN PËRPLASI PUSHTETIN DHE OPOZITËN NË KUVEND

Mimoza Kusari midis Kuvendit rrethohet me shiritin që mban mbishkrimin "rrezik"

Shefja e grupit parlamentar e LV-së, Mimoza Kusari-Lila, të enjten nuk e ka pasur një ditë të lehtë. Në seancën parlamentare ajo është injoruar nga deputetët e LV-së. Ndonëse në sallë ishin 60 deputetë të mazhorancës, askush prej tyre nuk i ka dalë në mbrojtje Kusari-Lilës, e cila, si asnjëherë më parë, ishte në thumb të kritikave të opozitës për bisedën e saj me Milan Radojiçiqin, e cila është publikuar një ditë më parë në "Paparaci". Ajo është nervozuar edhe më shumë kur deputeti i pavarur i Kuvendit, Haki Abazi, i ka mbështjellë me shirit, në të cilin shkruhej 'Danger' - 'rrezik', mikrofonin dhe foltoren e Kuvendit derisa ajo fliste

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 10 TETOR - Përgjimi i radhës që u publikua nga portali "Paparaci", ku shefja e grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, dëgjohej duke biseduar me Milan Radojiçiqin, ka përplasur të enjten pushtetin dhe opozitën në Kuvend.

Audioincizimet që janë publikuar të mërkurën nga portali "Paparaci" në mes të Kusarit dhe Radojiçiqit kanë të bëjnë me kalimin e Projektligjit për Pagën Minimale dhe për votimin e një kandidati për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese në qershor të 2022-s. Shefja e grupit parlamentar e LV-së, Mimoza Kusari-Lila, të enjten nuk e ka pasur një ditë të lehtë. Në seancën parlamentare ajo është injoruar keq nga deputetët e LV-së. Ndonëse në sallë ishin 60 deputetë të mazhorancës, askush prej tyre nuk i ka dalë në mbrojtje Kusari-Lilës, e cila, si asnjëherë më parë, ishte në thumb të kritikave të opozitës për bisedën e saj me Milan Radojiçiqin, e cila është publikuar një ditë më parë në "Paparaci".

Duke u munduar të mbrohet nga

akuzat e opozitës, ajo është dashur ta marrë disa herë fjalën. Jo rrallë në replikat e saj, Kusari-Lila ngruhe zërin duke e akuzuar opozitën për lidhjet me Radojiçiqin. Ajo është nervozuar edhe më shumë kur deputeti i pavarur i Kuvendit, Haki Abazi, i ka mbështjellë me shirit të policisë mikrofonin dhe foltoren e Kuvendit derisa ajo fliste.

Deputetët e opozitës bisedën e Kusarit me Radojiçiqin e kanë quajtur tmerr të demokracisë. "Ajo çka pamë dje është në vazhden e logjikës të cilën LV-ja e ka ndërtuar si logjikë të përbaltjes, duke qenë vetë e zhytur deri në fyt me kriminelin Milan Radojiçiq. Ky është tmerr i demokracisë në Kosovë. Ky është tmerr i përfaqësimit në Kosovë. Çka përfaqësojnë këta deputetë kur kryetarja e grupit të tyre parlamentar del akuzon? Para, prapa, anash, djathtas e majtas, pëshhtynë në tana anët, dhe këta entuziazmohen", ka thënë shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Arben Gashi.

Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Abelard Tahiri, ka thënë se kjo legjislaturë është e kontaminuar dhe e kriminalizuar. "Përveç faktit që

Milan Radojiçiq na e paska përcaktuar pagën minimale dhe na i ka përjashtuar kategoritë më të ndjeshme, më të lavdishme nga kjo pagë dhe që paska pasur edhe kandidat të tij për Gjykatë Kushtetuese nga radhët e shqiptarëve, në çka tjetër janë të involvuar dhe kanë marrëveshje me Milan Radojiçiqin?", tha ai.

Tahiri ka theksuar se PDK-ja nuk do të bashkëpunojnë në asnjë rrethanë me Lëvizjen Vetëvendosje përderisa grupi parlamentar i saj udhëhiqet nga Kusari-Lila. "Ne po jua bëjmë të qartë që me këtë parti politike nuk do të bashkëpunojmë në asnjë rrethanë, në asnjë moment, përderisa e kanë kryetare të grupit parlamentar një person që tashmë është e qartë që koordinimin për vendimmarrje në Kuvendin e Kosovës e bën me Milan Radojiçiqin, me vrasësin e Afrim Bunjakut", tha ai.

Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se ky Kuvend dhe qytetarët meritojnë ta dinë se për çfarë kushtesh është negociuar me terroristin Milan Radojiçiq. "Cili ka qenë pazari i këtij negociimi? Aty nuk flitet për ligje që kanë të bëjnë me komunitete. Nuk flitet për çështje

që trajtohen në Kuvend në raport me 2/3. Aty diskutohet për një ligj që prek secilin njeri për pagën minimale, dhe veteranët e UÇK-së. Ne duhet ta dimë se ky koordinim a është një thikë pas shpine ndaj demokracisë së Kosovës", ka thënë Besnik Tahiri. Ndërkaq lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, duke iu kundërpërgjigjur akuzave të LV-së, ka theksuar se ata kurrë nuk e kanë dashur asnjë të arritur të Kosovës ku ata s'kanë qenë protagonistë. "Kurrë s'e kanë dashur UÇK-në as trashëgiminë e saj. Kurrë s'e kanë nderuar një komandant të UÇK-së që nuk u nevojitet për kauzat e tyre të mbrapshta të pushtetit. Edhe kur vizitojnë varret e dëshmorëve, i vizitojnë sepse nuk janë të gjallë. Po të ishin të gjallë, do t'i quanin kriminelë. Kosova po qeveriset nga një mentalitet krejt antikombëtar që flet shqip e abuzon shqip, por asgjë shqiptare nuk ka", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Shefja e deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, ka theksuar se audioincizimet janë të falsifikuara. "Për keqardhje të dëgjosh shpifje, por edhe nxitje për urrejtje. Këtu duhet të jenë një ose dy argumente që PDK i ka për këtë debat. Ju keni pasur bashkëpunim

me Listën Serbe e po bëni falsifikime. E dyta, kaq shumë po ju mungojnë. Ju në pamundësi për t'i pasur ata, po i thirrni bashkëpunëtorët e tyre e po bëni falsifikime. A e dini ju se Radojiçiqi me qeverinë Kurti është i përndjekur e kurrë më nuk do të kthehet", ka thënë Kusari-Lila.

Opozita e ka lëshuar seancën e Kuvendit të Kosovës pasi nuk është përkratur kërkesa për të debatuar lidhur me bisedat e shesheve të grupit parlamentar të Vetëvendosjes, Mimoza Kusari-Lila, me kriminelin serb Millan Radojiçiq.

Rrjedhimisht, pushtetit i është pamundësuar mbajtja e seancës për shkak të mungesës së kuorumit.

Në hapësirën e foltores së Kuvendit, deputeti Abazi vendos shiritin me mbishkrimin rrezik

Në hapësirën e foltores së Kuvendit, deputeti Haki Abazi vendosi shiritin me mbishkrimin rrezik, duke reaguar ndaj bisedës që publiku dëgjoji në mes të deputetes Mimoza Kusari-Lila dhe Milan Radojiçiqit.

25-vjetori i themelimit të PDK-së, Krasniqi pret në takim bashkëshorten e Thaçit e të Veselit

PRISHTINË, 10 TETOR - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka shënuar të enjten 25-vjetorin e themelimit të saj.

Kryetari aktual Memli Krasniqi ka theksuar se u bënë 25 vjet krenari dhe 25 vjet punë. "Bashkë, drejt 25 viteve të tjera plot përkushtim dhe ëndrra të reja për Kosovën. Gëzuar!", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Krasniqi në këtë përvjetor të PDK-së, Krasniqi ka pritur bashkëshorten e ish-kryetarit të PDK-së, Hashim Thaçi dhe bashkëshorten e ish-kryetarit tjetër të PDK-së, Kadri Veseli, të cilët ndodhën në paraburgim në Hagë. "Në këtë përvjetor jubilar të themelimit të Partisë Demokratike të Kosovës, pata nderin dhe kënaqësinë të pres bashkëshorten e



Presidentit Hashim Thaçi, Lumnijen dhe bashkëshorten e Kryetarit Kadri Veseli, Violetën. Urimet që i shkëmbyem për këtë 25 vjetor, fatkeqësisht nuk ishin të

plota, sepse sot më tepër se çdoherë ndjehej mungesa e dy liderëve tanë", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Krasniqi ka shtuar më tutje se më



shumë se mall, sot ndiejnë krenari që pjesë të rrugëtimit të tyre jetësor i kanë dy burrëshetas të guximshëm që ndryshuan fatin e Kosovës, dy udhëheqës vizionarë që e ngritën,

zhvilluan dhe transformuan Republikën tonë, dy çlirimtarë që po vazhdojnë misionin e tyre në mbrojtje të së vërtetës së historisë së vendit dhe popullit tonë.

Retorika e pritshme zgjedhore dhe polarizimi i subjekteve politike në Kosovë për zgjedhjet e vitit 2025: Një qasje krahasimtare



Shkruan:
Prof. Dr. Fejzulla
BERISHA

Përdorimi i kartës nacionaliste në zgjedhjet parlamentare të Kosovës, më 9 shkurt 2025, është një temë që duhet analizuar thellësisht, duke marrë parasysh realitetin politik të brendshëm, ndërkombëtar dhe sfidat që përballon vendi. Nacionalizmi, si një mjet politik, ka pasur ndikim të madh në historinë e Kosovës dhe Ballkanit, shpesh duke luajtur një rol kyç në mobilizimin e qytetarëve dhe mbrojtjen e interesave kombëtare, por gjithashtu duke sjellë rrezikun e polarizimit dhe izolimit ndërkombëtar.

Një analizë historike e Kosovës, me historinë e saj të pasur dhe sfidues, ka kaluar nëpër periudha të zgjatura të pushtimit dhe represionit, veçanërisht gjatë sundimit serb dhe konflikteve të viteve 1990. Ndjenja nacionaliste ka qenë shpesh një përgjigje ndaj këtyre sfidave, duke u shfaqur si një formë mbrojtjeje dhe mbijetese kulturore dhe politike.

Lufta e Kosovës e viteve 1998-1999 dhe shpallja e pavarësisë në vitin 2008 kanë qenë momente kulminante që kanë përforcuar ndjenjat nacionaliste, të cilat vazhdojnë të jenë të pranishme në politikën e sotme. Në këtë kontekst, retorika nacionaliste në fushatën elektorale mund të ketë potencial për të mobilizuar elektoratin, veçanërisht ata që ndihen ende të kërcënuar nga tensionet me Serbinë ose që kanë një ndjeshmëri të lartë ndaj çështjeve të identitetit kombëtar dhe sovranitetit të Kosovës. Megjithatë, për të kuptuar efektet e mundshme të përdorimit të kartës nacionaliste në zgjedhjet e vitit 2025, është e rëndësishme të shqyrtojmë disa raste komparative nga vendet e tjera të Ballkanit dhe më gjerë.

Nacionalizmi si mjet mobilizues dhe rreziku i polarizimit pas shpalljes së pavarësisë në vitin 1991, Kroacia përjetoj një periudhë të fortë nacionalizmi, veçanërisht nën udhëheqjen e Franjo Tudjmanit dhe partisë së tij HDZ (Bashkimi Demokratik Kroat). Nacionalizmi u përdor si një mjet për të mobilizuar qytetarët kundër kërcënimeve të jashtme, sidomos gjatë luftës së viteve 1990 kundër Jugosllavisë dhe Serbisë. Përdorimi i retorikës nacionaliste ndihmoi HDZ-në të fitonte zgjedhjet dhe të konsolidojë pushtetin, duke paraqitur veten si mbrojtësit e pavarësisë dhe integritetit territorial të Kroacisë. Por, ndërsa nacionalizmi luajti një rol të rëndësishëm në periudhat e konfliktit, ai gjithashtu solli polarizim brenda shoqërisë kroate dhe tensione me komunitetet e pakicave etnike, veçanërisht serbët.

Retorika e fortë nacionaliste gjithashtu e vështirësoi procesin e integritetit të Kroacisë në Bashkimin Evropian, pasi shumë vende të BE-së shprehnin shqetësime për qëndrimet e ashpra të qeverisë kroate dhe mungesën e reformave demokratike. Mësimi nga rasti kroat është se, ndërsa nacionalizmi mund të ndihmojë në periudha të krizës, ai mund të bëhet një

pengesë për reformat e nevojshme demokratike dhe integrimin ndërkombëtar nëse përdoret në mënyrë të pakontrolluar. Në Kosovë, një retorikë e ngjashme nacionaliste mund të krijojë një ndarje të brendshme dhe të dëmtojë procesin e dialogut me Serbinë dhe integrimin evropian.

Një tjetër rast relevant për Kosovën është Maqedonia e Veriut, ku tensionet etnike midis maqedonasve dhe shqiptarëve kanë qenë të pranishme për dekada. Partitë politike në Maqedoninë e Veriut kanë përdorur shpesh nacionalizmin si mjet për të fituar mbështetje nga grupet e tyre etnike. Megjithatë, tensionet etnike dhe nacionalizmi ekstrem kanë çuar në dhunë, siç ishte konflikti i vitit 2001, i cili përfundoi me Marrëveshjen e Ohrit, një marrëveshje që promovoi decentralizimin dhe përfshirjen e shqiptarëve në qeverisje. Në zgjedhjet e mëvonshme, si dhe në referendumin për ndryshimin e emrit të vendit, partitë nacionaliste maqedonase dhe shqiptare kanë vazhduar të luajnë me kartën etnike. Por, qeveria e kryeministrit Zoran Zaev zgjodhi një qasje të ndryshme, duke u përqendruar më shumë te dialogu dhe bashkëpunimi ndër-etnik. Kjo qasje ndihmoi në përparimin e Maqedonisë së Veriut drejt integritetit në NATO dhe afrimit me Bashkimin Evropian. Rasti i Maqedonisë së Veriut tregon se, edhe në një mjedis me tensione etnike dhe ndjenja nacionaliste, një politikë që promovon dialogun dhe bashkëpunimin mund të jetë më e dobishme për stabilitetin afatgjatë dhe integrimin ndërkombëtar.

Nacionalizmi si pengesë për integrimin evropian. Në Serbi, nacionalizmi ka qenë një forcë dominuese që nga vitet 1990, me figura si Slobodan Milosheviq që përdorën kartën nacionaliste për të forcuar pushtetin dhe për të mbrojtur interesat e Serbisë në Ballkan. Pas luftërave jugosllave, shumë parti politike në Serbi vazhduan të përdorin nacionalizmin për të fituar mbështetje, veçanërisht në raport me çështjen e Kosovës.

Megjithatë, përdorimi i fortë i retorikës nacionaliste ka penguar Serbinë në rrugën e saj drejt integritetit në Bashkimin Evropian, pasi shumë vende të BE-së e shohin qëndrimin e ashpër të Beogradit ndaj Kosovës dhe mungesën e përparimit në dialog si një pengesë për anëtarësimin. Për të përparuar drejt integritetit evropian, Serbia duhet të bëjë kompromis dhe të angazhohet në dialog konstruktiv me Kosovën. Ky rast është një paralajmërim për partitë politike në Kosovë: një retorikë e tepruar nacionaliste mund të izolojë vendin dhe të ngadalësojë procesin e integritetit ndërkombëtar, sidomos në BE dhe NATO, që janë prioritetet kryesore për Kosovën.

Çfarë duhet të bëjnë subjektet politike në Kosovë? Në zgjedhjet e vitit 2025, partitë politike në Kosovë duhet të peshojnë me kujdes përdorimin e kartës nacionaliste. Në një vend me një histori të fortë të luftës për pavarësi dhe identitet kombëtar, nacionalizmi mund të sjellë përfitime afatshkurtra, duke mobilizuar bazën elektorale. Megjithatë, përdorimi i tij i

tepruar mund të krijojë ndarje të brendshme dhe të dëmtojë procesin e dialogut dhe integrimin ndërkombëtar të Kosovës.

Në vend të një retorike nacionaliste që mund të krijojë tensione dhe izolim, subjektet politike duhet të përqendrohen në: Reformat ekonomike dhe sociale: Zhvillimi ekonomik, lufta kundër korrupsionit dhe përmirësimi i institucioneve demokratike duhet të jenë prioritet. Këto janë çështje që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e përditshme të qytetarëve dhe janë thelbësore për përparimin e Kosovës.

Kosova duhet të vazhdojë angazhimin e saj në dialogun me Serbinë dhe të përpiqet të ndërtojë marrëdhënie të qëndrueshme me fqinjët e saj. Kjo është e domosdoshme për

stabilitetin afatgjatë dhe integrimin në Bashkimin Evropian.

Në zgjedhjet e ardhshme, subjektet politike në Kosovë do të duhet të promovojnë bashkëpunimin ndërkombëtar për të siguruar një zhvillim më të qëndrueshëm dhe për të përforcuar pozicionin e Kosovës në arenën globale. Kjo do të përfshijë thellimin e marrëdhënieve me partnerët strategjikë, si Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian, si dhe angazhimin me organizata ndërkombëtare për integrimin e Kosovës në struktura të tjera të rëndësishme politike dhe ekonomike. Gjithashtu, një fokus i veçantë duhet të kushtohet dialogut me vendet e rajonit për të ndërtuar një klimë bashkëpunuese dhe për të promovuar stabilitetin rajonal.



Osmani takon presidenten dhe kryeministrin kroat, kërkon vazhdimin e përkrahjes së Kroacisë për Kosovën

DUBROVNIK, 10 TETOR - "Agresori nuk duhet asnjëherë të shpërblehet me tokën e viktimit! Ashtu siç dështuan në Kosovë, Kroaci, Slloveni e Bosnjë-Hercegovinë, forcat barbare do të dështojnë edhe në Ukrainë. Liria dhe demokracia gjithmonë do të triumfojnë", ka thënë presidentja Vjosa Osmani, para liderëve të tjerë në Samitin Ukrainë-Evropë Juglindore në Dubrovnik.

Ajo ka theksuar se mësimet e së kaluarës na kujtojnë se akomodimi i agresorëve nuk

sjellë kurrë paqe të qëndrueshme. "Solidariteti ynë për popullin e Ukrainës është i rrënjësor thellë në vetë përvojën e dhimbshme të popullit tonë. Prandaj, do të vazhdojmë ta mbështesim të drejtën e popullit ukrainas për liri, për sovranitet dhe integritet territorial. Deri në fitore!", ka shkruar Osmani në "Facebook". Osmani në Dubrovnik ka takuar edhe presidenten e Sllovenisë, Natasa Pirc Musar. "Kosova dhe Sllovenia kanë qenë krah njëra-tjetres për vite me radhë, të nxitura nga vlerat e

përbashkëta. Me presidenten Pirc-Musar folëm për përkushtimin tonë të ndërsjellë që këtë aleancë të vazhdojmë ta forcojmë dhe avancojmë tutje", ka bërë me dije Osmani pas takimit.

Presidentja ka takuar edhe kryeministrin kroat. "Shpreha mirënjohjen time të thellë kryeministrit kroat Andrej Plenković për mikpritjen e ngrohtë në Dubrovnik, qytetin historik që përfaqëson qëndresën dhe krenarinë e popullit kroat. Në takim, riafirmuam partneritetin tonë



strategjik dhe diskutuam rëndësinë e mbështetjes së pandërprerë të Kroacisë në çdo

hap që ndërmarrim drejt institucioneve euroatlantike", ka pohuar Osmani.

Policia dhe Dogana parandalojnë tri raste të kontrabandës me mallra

EPOKA
ERE

Qndresa RAMA

PRISHTINË, 10 TETOR - Policia e Kosovës dhe Dogana e Kosovës (Njësia e Task Forcës - Lindje) në zbatim të masave për parandalim dhe luftimin e paligjshmërisë dhe kontrabandës, kanë shtuar kontrollet taktike dhe operacionale në zonën kufitare ku kanë parandaluar tri raste të kontrabandës me mallra.

Në të gjitha rastet veprimet policore veprimet janë ndërmarrë në bashkëpunim dhe koordinim me Prokurorinë e Shtetit. "Rasti i parë: Më 09.10.2024, pas marrjes së informatave për kontrabandim të mallrave nga Serbia në Kosovë nga njësitet e lartcekura, është kryer një kontroll në shtëpinë e personit të dyshuar në fshatin Rogoçicë, komuna e Kamenicës. Gjatë

kontrollit është hasur në mallra ushqimore prodhim serbe të cilat dyshohet se janë kontrabanduar nga Serbia në Kosovë. Lidhur me rastin me urdhër të prokurorit kompetent malli sekuestrohet dhe dërgohet në terminalin doganor Dheu i Bardhë dhe procedohet nga njësitet e Doganës së Kosovës", ka njoftuar policia.

Ndërkaq edhe rasti i dytë ka ndodhur më 9 tetor. "Nga njësitet e Task Forcës - Lindje është ndaluar një veturë me targa serbe drejtuar nga i dyshuari shtetas i Serbisë. Gjatë kontrollit është vërejtur se në veturë kishte të ngarkuara 14 pako me cigare pa asnjë dokument mbi prejardhjen e mallit, gjithsej 140 000 mijë copë cigare në vlerë rreth 15 000 euro. Me urdhër të prokurorit kompetent, malli dhe automjeti sekuestrohen dhe janë dërguar në terminalin doganor



Dheu i Bardhë, ndërsa i dyshuari është ndaluar për 48 orë", theksohet në njoftim. Edhe rasti i tretë ka ndodhur më 9

tetor, ku pas marrjes së informatave për kontrabandim të mallrave nga Serbia në Kosovë, nga njësitet e Task Forcës - Lindje është

kryer një kontroll në shtëpinë e të dyshuarit kosovar nga Kamenica. Gjatë kontrollit është hasur në mallra si duhan, cigare të llojeve të ndryshme me prejardhje serbe dhe pa banderola, filtër për cigare etj., dyshohet se janë sjellë në mënyrë ilegale në Kosovë. "Përveç mallrave të lartcekura janë hasur edhe monedha metalike nga 2 euro gjithsej 640 euro të cilat dyshohet se janë të falsifikuara, ku nga Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit-përkatesisht Njësia Rajonale në Gjilan (NJRHKEK-Gjilan) është iniciuar rasti 'Falsifikim i Parasë' nga neni 296 i KPRK-së. Me urdhër të prokurorit kompetent në Gjilan, malli dhe automjeti sekuestrohen dhe dërgohet në terminalin doganor Dheu i Bardhë, ndërsa i dyshuari është ndaluar për 48 orë", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Reagim i KMDLNj-së: Pse ishte Trandafilova në Prishtinë?!

Kryetarja e Dhomave të Specializuara - Gjykatës Speciale - ishte në vizitë në Kosovë ku pati takime me EULEX-in, ambasadorin gjerman dhe ministren e Drejtësisë së Kosovës.

Për dallim nga vizitat e mëparshme, kësaj radhe nuk u takua me shoqërinë civile, mediat, nuk pati konferencë për media apo intervista për media të preferuara. Në vizitat e mëparshme i binte gurit dhe drurit duke e arsyetuar Gjykatën Speciale dhe postin që e ka në përpjekje për ta informuar publikun "për punën e mirë të kësaj Gjykate..".

Kësaj radhe asnjë deklaratë as nga Trandafilova e as nga ministrja e Drejtësisë që nuk lë vend a mundësi



pa kritikuar sistemin e drejtësisë të Kosovës në ndërkohë që Gjykatën

Speciale nuk e kritikon ani pse deklarativisht thuhet se është pjesë e

sistemit të drejtësisë së Kosovës.

I vetmi që u deklarua ishte ambasadori Rohde me një deklaratë diplomatike.

Vizita e Trandafilovës, krejtësisht jotransparente është ana tjetër e medaljes së Gjykatës Speciale që mungesën e transparencës dhe llogaridhënies e ka shenjë dhe vulë identifikimi.

Duket se Trandafilova, në takim me EULEX-in mund të ketë biseduar për arrestime tjera eventuale apo sigurimin e dëshmitarëve të mbrojtur, me sajesa nga Serbia ndërsa me ministren e Drejtësisë mund të ketë biseduar për kompensimin e viktimave gjë që

MD-ja ka deklaruar se nuk ka bazë ligjore për zbatim të vendimeve të Gjykatës Speciale.

Ekaterina Trandafilova duhet të deklarohet për shkelje të drejtave të njeriut të privuarve nga liria që janë në burgun e Hagës, të gjithë shqiptarë dhe të gjithë shtetas të Kosovës. Duhet të deklarohet pse vonohet përkthimi i materialeve gjyqësore në gjuhën shqipe.

Nga aspekti i të drejtave të njeriut, vizita jotransparente e Trandafilovës është jolegale dhe e padëshiruar, për një shtet normal.

Për një vend me mendësi kolonialiste, kjo vizitë është e mirëseardhur.

Në veri protestohet kundër ndalimit të Arsenijeviqit

MITROVICË E VERIUT, 10 TETOR - Qindra qytetarë dhe aktivistë kanë protestuar të enjten në Mitrovicë të Veriut kundër arrestimit të liderit të partisë Demokracia Serbe, Aleksandar Arsenijeviq, të cilit i është caktuar masa e paraburgimit për 48 orë, një ditë më parë. Ai akuzohet për veprën penale "ngacmim".

Zëvendës drejtori i Policisë së Kosovës për veriun, Veton Elshani, i ka thënë Radios Evropa e Lirë se Arsenijeviqi është arrestuar me urdhër të Prokurorisë, në bazë të raportimit të Visar Sylës, shefit të kabinetit të kryetarit të Mitrovicës së Veriut. Në muajt e fundit, Arsenijeviq

sfidon pothuajse çdo ditë, me një bilbil, legjitimitetin e Kosovës në atë pjesë, si dhe pushtetin qendror.

Ai dhe kolegët e tij partiakë pretendojnë se bëhet fjalë për "aktivizëm politik" dhe protesta paqësore kundër regjimit të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti.

Kjo është hera e tij e pestë që ndalohet me bilbil në afërsi të zyrtarëve të Kosovës, me arsyetimin se po prish rendin dhe qetësinë publike.

Ai ka protestuar me bilbil edhe më 10 shtator, ditën kur Kurti e ka realizuar një vizitë në Mitrovicë të Veriut.

Edhe atëherë sektori civil



shqiptar dhe serb e ka dënuar arrestimin e tij, duke thënë se ai ka protestuar në mënyrë jo të dhunshme.

CEFTA miraton 9 marrëveshje të reja për ta nxitur tregtinë, punësimin dhe të drejtat e konsumatorit në të gjithë rajonin

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 10 tetor - Brenda CEFTA-s është shënuar një moment historik për bashkëpunimin ekonomik, pasi Komiteti i Përbashkët i CEFTA-s miratoi 9 marrëveshje të reja që synojnë ta transformojnë tregtinë dhe bashkëpunimin ekonomik. Këto marrëveshje premtojnë përfitime konkrete, duke thjeshtuar operacionet e biznesit, krijuar mundësi të reja pune dhe forcuar mbrojtjen e konsumatorëve.

Vetëm disa ditë para përvjetorit të 10 të Procesit të Berlinit, CEFTA po bën një hap vendimtar drejt realizimit të vizionit për një Treg të Përbashkët Rajonal. E bazuar në rregullat dhe praktikatat më të mira të BE-së, këto marrëveshje do të afrojnë tregjet e CEFTA-s me Tregun e Vetëm të BE-së dhe do ta zhblokujnë potencialin e Planit të Ri të Rritjes së BE-së.

Danijela Gaceviq, drejtoreshë e përkohshme në sekretariatit e CEFTA-s, ka theksuar se CEFTA ka

një rëndësi thelbësore për lëvizjen e lirë të mallrave dhe shërbimeve, duke nxitur rritjen ekonomike dhe integrimin. "Me këto vendime, po krijojmë një hapësirë ekonomike më të fortë dhe më të unifikuar, ku bizneset mund të rriten më shpejt dhe konsumatorët janë të mbrojtur edhe kur blejnë përtej tregjeve lokale. Ky është një moment i rëndësishëm për CEFTA-n, ndërsa po afrohem me shumë me tregun e BE-së. Përfitimet do të ndihen në të gjithë CEFTA-n. Kompanitë e vogla dhe të mesme do të fuqizohen për të eksportuar dhe për të shfrytëzuar më së miri tregjet digjitale, ndërsa të gjithë ne do të përfitojmë nga më shumë zgjedhje, çmime më të mira, cilësi dhe mbrojtje më të fuqishme të konsumatorit", ka theksuar ajo.

Pikat kryesore të 9 marrëveshjeve

1. Njohja e Programeve AEO: Bizneset me përfitime doganore në

tregjet e tyre do të gëzojnë këto privilegje në të gjitha 7 tregjet e CEFTA-s, duke përmirësuar shpejtësinë dhe efektivitetin e procedurave doganore, duke kursyer kohë dhe kosto të konsiderueshme.

2. Lehtësimi i Tregtisë Elektronike: Një kuadër i unifikuar do të mundësojë që bizneset të shesin online pa pengesa në tregjet e CEFTA-s, duke e bërë më të lehtë për konsumatorët të blejnë pa kufizime. Gjithashtu, do të vendosen standarde për mbrojtjen e konsumatorëve kur blejnë online.

3. Dorëzimi i Pakove: Rregullat e reja thjeshtojnë dorëzimin e pakove midis vendeve të CEFTA-s, duke përmirësuar kontrollin rregullator dhe duke vendosur standarde të BE-së për transparencën e çmimeve dhe cilësinë e shërbimit.

4. Parandalimi i Geo-blokimit të Pajustificuar: Këto rregulla sigurojnë që dyqanet online të mos bllokohen qasjen në faqe interneti, produkte ose shërbime bazuar në

vendndodhjen ose originën e konsumatorit, duke lejuar blerje pa pengesa në tregjet e CEFTA-s.

5. Aspektet Tregtare të Drejtave të Pronësisë Intelektuale (IPR): Standardet e harmonizuara të IPR do të mbrojnë si bizneset ashtu edhe konsumatorët nga mallrat e falsifikuara, duke nxitur inovacionin dhe mbrojtjen e tregut të CEFTA-s.

6. Krijimi i një Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Rrezikut: Shkëmbimi elektronik i të dhënave do t'i mundësojë doganave të targetojnë më efektivisht dërgesat me rrezik të lartë, duke përmirësuar sigurinë tregtare dhe duke përshpejtuar lëvizjen e mallrave.

7. Lehtësimi i Tregtisë së Shërbimeve nga Agjencitë e Udhëtimit dhe Operatorët Turistikë: Agjencitë e udhëtimit dhe operatorët turistikë do të kenë qasje më të lehtë në të gjitha tregjet e CEFTA-s, duke krijuar mundësi të reja për rritje dhe tërheqje më të madhe të turistëve në rajon.

8. Mekanizmi i Zgjidhjes së

Mosmarrëveshjeve (Protokolli Shtesë 7): Një mekanizëm i ri për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tregtare do të sigurojë drejtësi dhe transparencë, duke rritur besimin e bizneseve në zbatimin e rregullave të lehtësimi të tregtisë të CEFTA-s.

9. Lehtësimi i Sigurimit të Detyrimit të Tretë për Automjetet (Rekomandim): Proceset e thjeshtuara të sigurimit të automjeteve do t'u mundësojnë udhëtarëve të kalojnë nëpër CEFTA pa shqetësime për mbulimin e sigurimit.

Për më tepër, Komiteti i Përbashkët i CEFTA-s ka miratuar tre vendime të tjera që synojnë reformimin e çështjeve të tij të brendshme. Këto reforma prezantojnë Rregulla të reja të Procedurës për Komitetin e Përbashkët, përditësojnë Vendimin që rregullon funksionimin e Sekretariatit dhe krijojnë organe të reja për të mbikëqyrur bashkëpunimin në fusha të reja si dorëzimi i pakove, të drejtat e pronësisë intelektuale dhe kualifikimet profesionale.



Rama takon përfaqësuesit e bizneseve: Bizneset janë shtylla e zhvillimit ekonomik të Prishtinës

PRISHTINË, 10 TETOR - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka takuar përfaqësues të bizneseve nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, me të cilët ka diskutuar për sfidat dhe mundësitë që ofron kryeqyteti. Ai ka thënë se bizneset janë shtylla e zhvillimit ekonomik të Prishtinës dhe përkushtimi i tyre për inovacion e rritje

është për t'u lavdëruar. "Kryeqyteti është dhe do të jetë gjithmonë për bizneset, duke mbështetur zhvillimin e tyre përmes investimeve në infrastrukturë, përmirësimin e shërbimeve dhe lehtësimin e procedurave për sipërmarrësit. Përmes transformimit të Prishtinës në një Smart City, ne po synojmë jo vetëm të

krijojmë një qytet më të gjelbër dhe inovativ, por edhe të luftojmë informalitetin, veçanërisht në sektorë si transporti (siç është rasti i taksive). Me teknologji të avancuar dhe sisteme të integruara, do të sigurojmë një mjedis të rregullt dhe të kontrolluar, që u shërben më mirë qytetarëve dhe bizneseve", ka thënë Rama.



Pagova time bijë 100 dollarë, për të lexuar një libër

Mireille SILCOFF

Këtë verë, i dhashë vajzës sime 12-vjeçare 100 dollarë për të lexuar një libër. Sigurisht, ishte një përpjekje e fundit sa i përket manovrave prej mamaje dhe pagesa ishte e tepruar. Nuk mund të them se jam krenare – por jam jashtëzakonisht e kënaqur. Sepse plani funksionoi. Funksionoi aq mirë, sa do t'u sugjeroja prindërve të tjerë të lexuesve ngurrues, që të hapin portofolin dhe t'u japin ryshfet fëmijëve për të lexuar. Vajza ime është një fëmijë i zgjuar, padyshim më e zgjuar se unë kur isha 12-vjeç. Por deri kur përdora “ryshfetin”, ajo kurrë nuk kishte lexuar një libër të plotë, thjesht për kënaqësi. Lexonte libra për shkollën, por ta shtyje që ta bënte atë detyrë, ishte si t'i shkullje dhëmbët, dhe vetë ajo kishte lexuar disa romane me grafika, apo kishte dëgjuar me audio librat e serisë së “Harry Potter”-it. Asnjë prej këtyre nuk i hapi dyert drejt atij zakoni, që unë mund ta quaj lexim i thelluar klasik – me dy sy të ngulur përpara fletës, dhe injorim të gjithçkaje rretherrtull.

Kur u përballa me këtë të vërtetë disa muaj më parë, u ndjeva si një dështim si prind. Edhe pse ne kishim lexuar shumë libra me tregime kur ajo ishte më e vogël, dhe jetojmë në një shtëpi të mbushur me libra, nuk arrita t'i rrënjos fëmijës tim, një nga kënaqësitë themelore të jetës.

Pak kohë para pandemisë, një studim dëshpërues zbuloi se sa shumë kishte rënë leximi për kënaqësi tek fëmijët. Pothuajse 30 përqind e 13-vjeçarëve thoshin se “kurrë apo pothuajse kurrë” nuk lexonin për qejf, një rritje e konsiderueshme nga 8 për qind që thoshin të njëjtën gjë, afërsisht 35 vjet më parë. Duke qenë se koha e fëmijëve para ekranit u rrit gjithashtu ndjeshëm gjatë pandemisë, është e drejtë të konkludohet se leximi në kohën e lirë për fëmijët është një aktivitet, gjithnjë e më i rrezikuar të zhduket.

Për ne që kemi lexuar gjithë jetën – që i vlerësojmë netët e kaluara në dhoma të mbushura me kulla librash; ne që mbajmë ne mendje, sikur t'i kishim miq, idetë dhe personazhet që kemi koleksionuar ndër vite nga faqet e shtypura – përcjellja e rëndësisë së leximit tek fëmijët,

nuk duhet të jetë e vështirë. Ne të gjithë jemi të vetëdijshëm se leximi forcon strukturën e mënyrës si e përjetojmë jetën, çdo ditë. Megjithatë, unë e pata çuditërisht të vështirë t'ia komunikoj këto vajzës sime, e cila ngurronte të lexonte. Ajo më pohoi se nuk i pëlqente leximi. Për më tepër, as nuk i interesonte që t'i pëlqente. Dhe nuk e shihnte asnjë prej këtyre, si problem. Shumë prej shoqeve të saj, më shpjegoi, thjesht “nuk ua ndjente” për leximin. Kuptova që nëse doja t'ia komunikoj fëmijës tim gëzimin e leximit, duhej të sqaroja se çfarë gëzimi ishte ky, për veten time.

Sigurisht, fakti që i bleva një telefon inteligjent vitin e kaluar – një iPhone i dorës së dytë me një milion kontrole prindërore dhe kufizime kohore – është pjesë e problemit. Përpara telefonit, kisha një fëmijë që ishte shumë e shoqërueshme, që klithte me kënaqësi edhe për gjëra shumë të thjeshta, si fjala vjen, një ëmbëlsirë e sapobërë që ftohej në frigorifer. Pasi i dhashë telefonin, kisha tashmë një vajzë që komunikonte vetëm me fjalë njerëzore, e cila donte vetëm të rrinte në dhomën e saj me perdet e ulura, me derën mbyllur, nën jorgan, duke e mbajtur fort në pëllëmbë atë pajisje të vogël drejtkëndëshe, a thua po ta lëshonte, do i zhdukte krejt jetën e vet sociale. Po të mos ishte duke u marrë me shoqet, ose me telefonin, për çdo gjë tjetër kishte veç një fjalë: “Boring!” (e mërzitshme).

A keni provuar ndonjëherë t'i kërkonti një 13-vjeçari, që ndodhet nën regjim disa orësh ndalimi përdorimi të celularit, që të nxjerrë setin e vjetër të lapëstilave? Apo që të merret me origami? Nëse nuk doni që t'ju bien flokët prej vështimit gjithë inat, që del si rreze lazer nga sytë e adoleshentëve, mos e bëni!

Por mbajta një farë shprese tek leximi. Sepse mund të shihja që ajo çfarë vajza ime kërkonte, si shumë bashkëmoshatarë të tjerë, ishte “arratisja”. Dhe kjo më dukej e përshtatshme nga ana zhvillimore. Problemi ishte se mënyra më e kollajtë për të për të gjetur shpëtimin ishte të zhytej në kaosin e varësisë prej telefonit.

Kështu që, bëra fushatë. I thashë se duhej të lexonte sepse romanet janë mënyra më



e mirë për të mësuar se si funksionon brendia e njeriut. Ajo më tha se mund të mësonte më shumë nga shikimi i njerëzve që ndiqte në mediat sociale, të cilët sipas saj flisnin aty gjithçka që ndjenin së brendshmi.

I thashë se librat të ofrojnë RRËFIMIN. Ajo më tha: “Po Netflix”-i?

I thashë se librat të mësojnë historinë. Ajo më tha: “Po Interneti”?

I thashë se leximi do ta ndihmonte të kuptonte veten, dhe ajo ma ktheu: “Hmmm, jo faleminderit. Thjesht do jetoj.”

I premtova, në mënyrë ekstravagante, se do t'i blija të gjitha librat që donte dhe do të ndërtoja rafte librash në dhomën e saj, në mënyrë që ajo të mund të shikonte kolonat e të gjithë librave që donte nga shtrati i vet. Ajo ma ktheu: “Mami, mirë se erdhe në ëndrrën tënde!”

Kuptova se nuk mund t'i fitoja debatet me të, sepse vetëm pak prej argumenteve të vajzës sime kundër leximit, më dukeshin të gabuara. Po, leximi është një mënyrë për të zgjeruar universin dhe për të zbuluar botë të reja – por kështu është i gjithë interneti. Kështu që këto debate, të cilat na bezdisnin të djavave, do të reduktoheshin pashmangshmërisht në dërdëlitjet e mia për aftësitë njohëse dhe se si “leximi është i mirë për ty”.

Kjo nuk është arsyeja pse doja që ime bijë të kapte një libër. Nuk kishte të bënte me opti-

mizimin e funksionit të trurit të saj, por se doja t'i bëja të qartë se ishte duke humbur përjetimin e një magjie. E keni parasysh atë momentin, kur një shkrimtar përmbledh një ndjenjë që ti as nuk e dije që e kishe dhe, menjëherë të ndizen 100 llamba që të ndriçojnë brenda kokës, si në një lojë epifanie? Doja që ajo të kishte një shans për ta përjetuar këtë. Siç shkruante Neil Postman në vitin 1982 tek “Zhdukja e fëmijërisë”, një medium i bazuar në ekran, siç është TV apo video nuk mund të krijojë këtë lloj marrëdhënieje sepse, për nga vetë natyra e tij, mediumi duhet të plotësojë të gjitha boshllëqet tuaja. Librat lënë hapësirë për boshllëqe – dhe për krijimet e brendshme që ata mund të frymëzojnë.

Kështu që vendosa të ndërpres të gjitha arsyetimet me një praktikë të ftohtë dhe të vështirë: paratë! I thashë 12-vjeçares sime se do t'i paguaja 100 dollarë nëse do të lexonte një roman.

Ajo tha: “Çfarë? Vërtet?”

Pastaj, sigurisht, që tha po.

Diskutova me miq që kanë fëmijë adoleshentë, se cili libër do të funksiononte për të ndezur dëshirën e saj për të lexuar. Ndërsa disa prej tyre, për habinë time, më sugjeruan tituj të tillë si “Princi i vogël” dhe “Lartësitë e stuhishme”, libri që më sugjeruan më shpesh njerëz që e njohin vajzën time ishte “Vera kur u bëra e bukur” i

Jenny Han, i cili ishte shndërruar madhe në një serial të famshëm në Amazon Prime. Vajza ime e kishte parë dhe e donte.

Unë ndërmjetësova ujdinë mes nesh: 100 dollarë nëse e përfundonte librin brenda një muaji. Më pas u nisëm për pushime në plazh, së bashku me të dashurin tim, në një ishull romantik grek.

Pushimet zgjatën tetë ditë dhe para se të mbaronte dita e shtatë, ime bijë e kishte mbaruar librin. Kur u kthyem në shtëpi, ajo kërkoi vazhdimin, të cilin e përfundoi për rreth dy javë – pa asnjë pagesë shtesë.

A do të çojë kjo time bijë drejt leximit të librit “Gra të vogla”? Të përpijë “Kapëse në thekër” apo “Dhëmbë të Bardhë”? A do të rezultojë në një jetë të gjatë të mbushur me lexime, me pirgje librash, të cilët do t'i shohë si miq, mësues, stimulues dhe balsam për çfarëdo halli?

Nuk e di. Ajo që di është se vajza ime tani ka artikuj të rinj të blerë tek Sephora, me vlerë 100 dollarë, të cilat vitin e kaluar kisha refuzuar t'ia blija. Di gjithashtu se së bashku, më në fund hapëm një portë të re për të, drejt faqeve të shtypura: një vend i qetë personal, që imagjinoj – shpresoj – do t'i shërbejë asaj për gjithë jetën. Kam ndjesinë se është 100 më i mirëshpenzuar. / The New York Times – Bota.al



Kosova niset drejt Lituanisë, Rramani dhe Rrudhani paralajmërojnë fitore

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

Prishtinë, 10 tetor - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll zhvilloi të enjten seancën e fundit stërvitore në Kampin Nacional në Hajvali, derisa pasdite ka udhëtuar drejt Lituanisë ku të shtunën e zhvillon ndeshjen e Ligës së Kombeve nga ora 15:00.

Në këtë seancë stërvitore u rikthye portieri Arijanet Muriq, derisa për shkak të një lëndimi, mbrojtësi Leart Paqarada është liruar nga grumbullimi.

Federata e Futbollit e Kosovës ka njoftuar se përzgjedhësi Franco Foda dhe stafi i tij teknik u fokusuan në detajet taktike të cilat janë shumë të rëndësishme për këtë sfidë. "Futbollistët punuan me intensitet të lartë, duke përmirësuar ndërveprimin mes reparteve dhe përgatitjen për

situata të ndryshme që mund të paraqiten gjatë lojës në fushë", thuhet në njoftimin e FFK-së. Pas stërvitjes kanë folur dy futbollistët "dardanë", Albion Rrahmani dhe Donat Rrudhani, të cilët besojnë se Kosova do t'i marrë pikët e plota në Kaunas, më pas edhe në Prishtinë.

Albion Rrahmani ka thënë se "dardanët" e kanë studiuar mirë kundërshtarin e ditës së shtunë, Lituaninë, dhe se do të mundohen t'i shfrytëzojnë pikat e dobëta dhe t'i marrin pikët e plota. "Lewa" i Kosovës pret pikë maksimale edhe ndaj Qipros në ndeshjen që zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri". "Jemi mirë të përgatitur dhe atmosfera është shumë e mirë për këtë ndeshje. Shpresojmë në rezultat pozitiv. Të nisim mbarë në ndeshjen e më parë e me pas të marrim pikë edhe në ndeshjen



kthese në 'Fadil Vokrri'. E kemi analizuar mirë kundërshtarin dhe jemi duke punuar në të gjitha pikat ku mund ta dënojmë kundërshtarin", ka thënë Rrahmani. Në të njëjtën linjë me Rrahmanin është edhe Rrudhani, i



cili konfirmoi se gjithçka ka shkuar mirë në përgatitje dhe se presin tri pikët e plota ndaj Lituanisë. "Atmosfera është shumë e mirë gjithmonë kur vijmë te Kosova. Kemi stërvitur në mënyrë intensive këto ditë dhe kemi

punuar shumë taktikisht dhe gjithçka ka shkuar sipas planit. Lituaninë e kemi analizuar këto tri ditët e fundit e dimë se çfarë kualiteti ka, por ia dimë edhe dobësitë. Besoj se do t'i marrim tri pikët", ka thënë Rrudhani.

Paqarada lirohet nga grumbullimi

Mbrojtësi i Kolnit, Leart Paqarada, është liruar nga grumbullimi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll për ndeshjet kundër Lituanisë dhe Qipros për shkak të lëndimit. Gjatë dy ditëve të kaluara Paqarada në përgjithësi ka stërvitur i diferencuar nga pjesa tjetër e ekipit, teksa pas ekzaminimeve mjekësore u vendos që ai të lirohet dhe të kthehet në klubin e tij për trajtimin e nevojshëm.

Taulant Xhaka: I propozova Granitit të mos luajë kundër Serbisë

CYRRI, 10 TETOR - Zvicra të shtunën do të përballlet me Serbinë në kuadër të Ligës së Kombeve. Pas dueleve në Botërorin 2018 dhe 2022, të gjithë sytë janë te kapiteni i Natit, Granit Xhaka. Ndërkohë, në Serbi i vlerësojnë aftësitë futbolistike të Xhakës. "Mendova se s'është e vërtetë", thotë për "Blick" Taulant Xhaka për momentin kur u shpall shorti me Serbinë si kundërshtarë e Zvicrës në Ligën e Kombeve. Fakti që tani është ndeshja e parë në Serbi për kapitenin e Natit, Granit Xhaka pas dueleve të nxehta në Botërorin 2018 në Rusi dhe 2022 në Katar, është marrë me shqetësim nga familja e tij. Vetë Taulant Xhaka ishte në stadiumin e Beogradit në vitin 2014 kur u ndërpre ndeshja me kombëtaren shqiptare kundër Serbisë. "Unë e di vetë se sa presion dhe emocion duhet të durosh në këtë lojë. Kjo është arsyeja pse vëllai i madh e mori telefonin në Bazel



menjëherë pas shortit", siç tregon ai për "Blick". "I propozova Granitit që të fliste me trajnerin Murat Yakin dhe, ndoshta, ta shmangte këtë lojë, por të gjithë e njohim vëllanë tim: ai dëshiron të luajë çdo ndeshje për Zvicrën", ka thënë Taulant Xhaka.

33-vjeçari shpreson, para së gjithash, që të mos jenë ditë kaq emocionale dhe kaotike si në duelet e mëparshme. "Nuk është e lehtë ta mbash veten nën

kontroll gjatë 90 minutave kur bëhet përsëri kaq emocionale. Graniti duhet të qëndrojë i qetë, të luajë futboll, të fitojë dhe t'i injorojë provokimet. Është e lehtë të thuash, por në fund gjithçka ka të bëjë me këtë: të luash ndeshje futbollit dhe të fitosh". Federata Zvicerane e Futbollit dëshiron ta mbajë këtë çështje sa më të vogël që të jetë e mundur. "Këto janë histori të vjetra. Është një lojë si çdo tjetër",

thotë drejtori i Natit, Pierluigi Tami. Mendimi është i ngjashëm nëse pyet futbollistët në Zvicër. "Pres një ndeshje normale futbollit dhe mendoj se të dyja palët kanë mësuar nga e kaluara", ka thënë ish-bashkëlojtari i kombëtare zvicerane, Admir Mehmedi.

Në të njëjtën mënyrë e vlerëson situatën edhe kapiteni i klubit Grasshoppers, Amir Abrashi, i cili aktualisht është në kombëtaren shqiptare dhe ka luajtur përkrah Taulant Xhakës në vitin 2014. "Nuk do të jetë aq e nxehtë si në të kaluarën. Përveç kësaj, ka mbetur vetëm Graniti - në dy duelet e fundit shumë është zier edhe rreth Xherdan Shaqirit", ka thënë Abrashi. Dhe si e shohin serbët këtë çështje? "Granit Xhaka perceptohet si provokator kur sheh se si është sjellë në ndeshjet e fundit", thotë gazetari serb i futbollit, Velko Ivanoviq, i "Sportal.rs". Ai përmendi rastet e Xhakës, nga kapja e organit gjenital, fanella e Jasharit në

Botërorin e Katarit apo festimi me shqiptonjën dykrenare në Botërorin e Rusisë. Pas dy dueleve mes Serbisë dhe Zvicrës, të cilat kanë bërë mjaft tituj jashtë fushës, serbët janë të mendimit: "Nuk duam të merremi më me gjëra që kanë pak lidhje me futbollin". Kjo i referohet historisë së familjes Xhaka, për shembull: Prindërit janë me prejardhje kosovare, dhe babai ka qenë dikur në burg për arsye politike në shtetin e atëhershëm multi-etnik të Jugosllavisë. Sigurisht që kapiteni i Zvicrës duhet të presë fishkëllima dhe brohoritje të shtunën në stadiumin Dubočica në Leskovc. "Por edhe në Serbi e njohin se çfarë futbollisti i shkëlqyer është Granit Xhaka", ka thënë Ivanoviq. Trajneri i Serbisë, Dragan Stojkoviq, e ka vlerësuar sërish kapitenin e Natit para medieve vendase: "Ai është një lojtar i madh që ka shumë vite që luan në një nivel botëror. E vlerësoj shumë".

Istogu dhe Samadrexha, në fundjavë ndeshjet e radhës në Kupat Evropiane

ISTOG, 10 TETOR - Në tri prej shtatë paraqitjeve të deritashme, KHF Istogu ka kaluar kundërshtarë në garat evropiane. Këtë sukses skuadra istogase e hendbollisteve e kërkon edhe në fundjavë në Pejë. Në kuadër të raundit të dytë të Kupës Evropiane (EHF European Cup) për

hendbolliste, kampioni i Kosovës, Istogu, përballlet me skuadrën greke AESH Pylaia Thessaloniki. Klubet kanë arritur marrëveshje që dy ndeshjet të zhvillohen në Kosovë. Pasi palestra në Istog nuk është ende gati për ndeshje, istogaset do të luajnë në palestrën "Karagaçi" në Pejë.

Ndeshja e parë është të shtunën nga ora 19:00, ndërsa e dyta të dielën nga ora 19:00. Fakti se dy ndeshjet zhvillohen në Kosovë, e favorizon Istogun. Edhe përvoja në gara evropiane është në anën e skuadrës kosovare. Istogu pritet të ketë edhe përkrahje të madhe në tentim për të kaluar në raundin

e tretë të Kupës Evropiane. Ndërsa Samadrexha në fundjavë do të paraqitet në xhiron e dytë të Kupës Evropiane për hendbolliste. Përballë skuadrës samadrexhase do të jetë skuadra nga Portugalia, ColegioGaia/Colgaia-Toyota. Klubet janë pajtuar që dy



ndeshjet të zhvillohen në Vila Nova de Gaia në Portugali. Ndeshja e parë është të shtunën nga ora 18:00, e dyta të dielën nga ora 18:00.

Federeri: Tani shijoj jetën si spektator, ndihem pjesë e sportit kur jam në turne tenisi

CYRIL, 10 TETOR - Edhe pse i tërhequr nga sporti prej dy vitesh, tenisti zviceran Roger Federer mbetet një nga më të mëdhenjtë e këtij sporti. Edhe sot që nuk luan më, miliona fansa duan të dinë detaje të karrierës dhe jetës së tij, sidomos tani që ka "varur raketën në gozhdë". Në një

intervistë për mediet gjermane, Federeri foli për karrierën e tij dhe zbuloi: "Jam i lumtur që jam rikthyer për të marrë pjesë në disa turne, natyrisht si spektator. Kam arritur ta pranoj pensionin tim dhe ndihem ende pjesë e këtij sporti kur marr pjesë në turne tenisi". "Unë nuk jam një alien dhe nuk jam ndryshe nga

të tjerët. Në fakt, kur jam në një turne, më shqetëson kur më pyesin se çfarë po bëj këtu. Unë nuk do të kthehem kurrë të luaj", ka deklaruar Federer. "Jam i lumtur që ndihem ende rehat në shtëpinë time, por edhe në ambientin e tenisit. Këtu ndihem rehat sikur të isha në shtëpi. Ndhem mirë edhe duke

kuptuar se nuk ka më nevojë të jem në turne", u shpreh zvicerani. Duke folur për çështjen e dopingut me Sinner, ai ka shtuar: "Të gjithë jemi mjaft të bindur që Jannik nuk bëri asgjë. Ndoshta ai nuk duhet të kishte luajtur, ndërkohë që ata nuk ishin 100 % të sigurt se çfarë po ndodhte".



Drenica dhe Rilindja me trajnerë të rinj

DRENICË, 10 TETOR - Dy skuadrat e Ligës së Parë, Drenica dhe Rilindja 1974, kanë emëruar trajnerë të rinj. Klubi kuqezi nga Skenderaj e ka paraqitur Bylbyl Sokolin, pas ndërpreu bashkëpunimin me Megzon Visokën. "Bylbyl Sokoli emërohet trajner i ri. Drejtuesit e klubit kanë arritur marrëveshje që Bylbyl Sokoli të emërohet kryetrajner i ekipit. Marrëveshja më 'Profën' është njëvjeçare dhe ai do ta fillojë menjëherë punën me skuadrën. Sokoli sot gjatë ditës është prezantuar si kryetrajner i skuadrës në ambientet e klubit. 'Profa' ka qenë pjesë e shumë skuadrave shqiptare dhe kosovare, kurse tashmë do të jetë pjesë e klubit tonë për kampionatin 2024/25", ka njoftuar Drenica. Ndërsa klubi nga Rrafshi i Dukagjinit, Rilindja 1974, e ka paraqitur Faruk Statovcin në vend



të Miftar Ramës së larguar. "Rilindja 1974 mirëpret sot me entuziazëm trajnerin e ri Faruk Statovci. Ky emërim përbën një hap të rëndësishëm për klubin, i cili synon ta forcojë pozitën e tij në ligë dhe të sjellë një frymë të re në ekip. Statovci vjen me një



eksperiencë të pasur në futbollin vendor dhe ndërkombëtar. Me një karrierë të gjatë si lojtar dhe trajner, ai ka dëshmuar aftësitë e tij në ndërtimin e ekipeve të forta dhe strategjive inovative që çojnë drejt sukseseve të mëdha", thuhet në njoftimin e Rilindjes.

Fundi i një epoke, legjenda Nadal pensionohet nga tenisi

MADRID, 10 TETOR - Rafael Nadal, 38-vjeçar, njoftoi tërheqjen e tij nga tenisi këtë të enjte. Në një video që zgjat më shumë se katër minuta, Nadali jep që në fillim lajmin: "Jam këtu për të njoftuar se po tërhiqem nga tenisi profesionist. Ishin vite të vështira, sidomos dy të fundit. Nuk isha në gjendje të luaja pa kufizime. Është pa dyshim një vendim i vështirë, që më mori pak kohë për ta marrë, por në këtë jetë çdo gjë ka një fillim dhe një fund". "Besoj se është koha e duhur për t'i dhënë fund një karriere të gjatë dhe shumë më të suksesshme nga sa mund ta imagjinoja", ka shtuar ai. "Por unë jam shumë i lumtur që turneu im i fundit është finalja e Kupës Davis që përfaqëson vendin tim. Është një rreth i plotë që vjen, pasi një nga gëzimet e mia të para si tenist ishte finalja në Seville më 2004. Ndhem me fat që



isha në gjendje të përjetoj gjithçka". Në dy vitet e fundit karriera e tij u ndikua nga një dëmtim i rëndë i kofshës, i cili e detyroi t'i nënshtrohej një operacioni në vitin 2023. Ai u kthye, por kurrë në njëqind për qind. Ai falënderon të gjithë industrinë e tenisit, të gjithë

partnerët për caq shumë vjet. Kam kaluar shumë gjëra me ta dhe kam përjetuar shumë momente që do t'i kujtoj gjatë gjithë jetës sime. Mbreti i Roland Garros, me 14 trofe, dhe 22 Grand Slame në total, e var raketën në "Davis Finals", në Malaga, ku Spanja debuton kundër Holandës.

SHKURT

Gruda: Prindërit i kam nga Shqipëria, por zemra më thotë të luaj për Gjermaninë

Sulmuesi i Brightonit, Brajan Gruda, duket se është i vendosur për ta përfaqësuar Gjermaninë në nivelin ndërkombëtar. Pavarësisht prej raportimeve këta muajt e fundit se Gruda po e konsideron kalimin te Shqipëria, gjërat duket se janë krejtësisht ndryshe. Në një intervistë së fundmi për "Allgemeine-zeitung", Gruda ka thënë se ndihet rehat te Gjermania dhe zemra i thotë të vazhdojë njësoi. "Nuk e di çfarë mban e ardhmja. Prindërit e mi janë nga Shqipëria, kam luajtur për kombëtaren që kur isha i vogël, u lida në Gjermani, këtu ndihem rehat. Për momentin duket se do të vazhdoj të luaj për Gjermaninë. Zemra më thotë se dua të luaj për Gjermaninë", deklaroi shkodrani. Gruda kësaj mund të bëhet lojtari i dytë shkodran pas Shkodran Mustafit që zgjedh Gjermaninë para Shqipërisë në nivelin ndërkombëtar.

Kvaratskhelia: Krenar që jam gjeorgjian, ëndërroj kualifikimin në Kupën e Botës

Ylli gjeorgjian Khvicha Kvaratskhelia ka dhënë një intervistë interesante për grumbullimin e Kombëtares. Kvara shprehet se ëndërron të kualifikohet me Gjeorgjinë në Kupën e Botës. "Dua të jem i dobishëm për vendin tim. Duke marrë parasysh atë që bëj sot, besoj se po e ndihmoj Gjeorgjinë dhe Gjeorgjia po më ndihmon mua. Jam jashtëzakonisht krenar që jam gjeorgjian. Falënderoj Zotin që kam lindur në Gjeorgji dhe që jam bir i këtij vendi historik! Ëndërroj të kualifikohem në Kupën e Botës me Gjeorgjinë", ka thënë Kvaratskhelia. Gjeorgjia do të përballet me Shqipërinë më 14 tetor në ndeshjen e vlefshme për Ligën e Kombeve.

Totti: Ja si e fituam Kupën e Botës në vitin 2006

Në intervistën e tij të fundit me "Tuttomercatoweb", legjenda e Italisë, Francesco Totti, kujtoi kampionatin fitues të Kupës së Botës 2006 për "Azzurrët", duke thënë se sekreti ishte një grup i fortë, pavarësisht nga cilësitë e lojtarëve. Totti ishte pjesë e një skuadre legjendare të Italisë që fitoi Kupën e Botës 2006 të mbajtur në Gjermani. Të gjithë lojtarët nga ai ekip, plus trajneri Marcello Lippi, u ribashkuan në Viareggio në fillim të kësaj jave. "Ishte një darkë e këndshme. Të gjithë ishin të lumtur dhe ishte kënaqësi të ribashkohesha pas caq shumë kohësh", ka thënë fillimisht Totti. "Ajo skuadër ishte një nga më të mirat, por ajo që na bëri të bëheshim të mëdhenj ishte grupi. Të gjithë shkuam në të njëjtin drejtim", ka përfunduar legjenda italiane. Gjatë së njëjtës intervistë, Totti foli për zhgënjimin e Daniele De Rossit për shkarkimin nga Roma muajin e kaluar dhe këmbënguli se ai nuk ishte i befashuar nga rezultatet e Antonio Contes në Napoli.

Warriors thyen rekordin historik kundër Kingsit


Klay Thompson, një nga gjuajtësit më të mirë të të gjitha kohëve dhe ikona e epokës më të mirë të Warriorsit, është larguar, por skuadra dëshiron t'i qëndrojë besnike stilit të saj të lojës. Kjo u demonstrua në miqësoren

kundër Kingsit, në të cilën Golden State theu rekordin e të gjitha kohëve për trepikëshat e realizuar. Skuadra nga San Francisco realizoi 28 nga 52 tentativa gjithsej për tri pikë, me një përqindje brutale suksesi prej

53 %, duke thyer rekordin e saj më të mirë në sezonin e rregullt dhe duke qëndruar vetëm një trepikësh larg majës absolute të NBA-së, të mbajtur nga Bucks: 29 trepikëshat kundër Bucksin në dhjetor 2020. Buddy Hield, i

afuar në këtë skuadër për ta mbushur boshllëkun e lënë nga largimi i Thompsonit, kryesoi festivalin e trepikëshave me 6/7 për të qenë pikëshënuesi më i mirë me 22 pikë. De'Anthony Melton dhe Jonathan Kuminga

shënuan nga katër, Stephen Curry dhe Lindy Waters III shënuan nga tre, Moses Moody, Draymond Green dhe Brandin Podziemski shënuan nga dy dhe Kyle Anderson dhe Reece Beekman shënuan nga një.



Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT-Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, dhe nenit 8 par. 4, nenit 11, nenit 21 nën par. 2.2 dhe nenit 25 të Rregullores Nr. 55/21 për Marrëdhënien e Punës të N.P.L. "Përparimi" Sh. A. në Vushtri e miratuar me datë 21.12.2021 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L. "Përparimi" Sh. A., e duke u bazuar në vendimin me nr. të protokollit 02/24 të datës 09.10.2024 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L. "Përparimi" Sh. A me datë 10.10.2024 shpall:

KONKURS PUBLIK

- I. Titulli:** Sigurim Fizik - roje
Numri i ekzekutuesve: 1
Orët e punës: 40 orë në javë
Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit, nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.
Përgatitja profesionale: Shkolla e Mesme apo fillore
Përvoja e punës: Preferohet gjashtë (6) muaj
I raporton: Udhëheqësit të Njesisë së Sigurimit Fizik
Lartësia e pagës mujore: 390.00Euro Bruto.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryejë detyrat e punës;
- Përkujdeset mbi sigurimin e objektit dhe pasurisë të institucionit publik;
- Në rast të ndonjë rreziku lajmëron menjëherë personat kompetent;
- Sipas nevojës mund të caktohet edhe në lokacion tjetër për sigurim fizik;
- Është i obliguar të përdorë të gjitha mjetet e parapara të mbrojtjes në punë;
- Të jetë i aftë që të përdor mjetet kundër zjarrit;
- Për punën që e kryen i përgjigjet Udhëheqësit të Njesisë së Sigurimit Fizik;
- Kryen dhe punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes.

Kushtet e veçanta

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Shkathësi fizike, preferohet të ketë të përfunduar trajnime nga fusha e sigurisë;
- Preferohet të jetë i licencuar në fushën e sigurimit fizik;

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L. "Përparimi" Sh. A - Vushtri.;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

> Kriteret e përgjithshme që duhet t'i plotësojnë të gjithë kandidatët

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë veprimi.
- Të zotërojë të paktën njëren nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët.

> Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

- Testimi me shkrim deri në shtatëdhjetë (70) pikë.
- Intervista me gojë deri në njëzetë (20) pikë
- Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit deri në dhjetë (10) pikë.

> Periudha e aplikimit të kandidatëve dhe kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të të njëjtit. Shpallja është e hapur nga data 11.10.2024 deri me datë 25.10.2024 në ora 16:00.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Verifikimi paraprak i aplikacioneve të kandidatëve më së largu deri me datë 01.11.2024.
- Afati për ankesë nga data 04.11.2024 deri me datë 06.11.2024.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen testit me shkrim, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 19.11.2024.
- Afati për ankesë nga data 20.11.2024 deri me datë 22.11.2024.

- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen intervistës me gojë, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 02.12.2024.
- Afati për ankesë nga data 03.12.2024 deri me datë 05.12.2024.
- Publikimi i rezultateve përfundimtare në lidhje me kandidatit e suksesshëm është më së largu 10.12.2024.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo, dhe varësisht nga puna e komisionit vlerësues, dhe departamentit të personelit. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njëjta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

> Mënyra e aplikimit dhe komunikimi me kandidatët

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në Zyrën e Arkivës të N.P.L. "Përparimi" Sh. A në qytetin e Vushtrisë, rr. "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Departamenti i Personelit duke zbatuar nenin 8 par. 3 të Udhëzimit MFPT-Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, do tu ofrojë sqarime të nevojshme për kandidatët në lidhje me kriteret e konkursit publik, dhe do tu asistoj dhe tu jap udhëzimet e nevojshme për aplikim me anë të adresës elektronike.

Dorëzimi i aplikacionit me gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: hrperparimi@gmail.com.

N.P.L. "Përparimi" Sh. A në Vushtri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

I gjithë komunikimi gjatë procedurave të konkursit publik do të zhvillohet nëpërmjet komunikimit elektronik.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

> Përfundim

N.P.L. "Përparimi" Sh. A në Vushtri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, dhe inkurajohen komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar, dhe gjinia më pak e përfaqësuar që të aplikojnë.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Xhavit Krasniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. "Hamëz Cena" Demjan nga kl.1-8.

- Adlije Krasniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u "Hamëz Cena" Damjan nga kl. 1-5,6-9.

- Selvije Hoti shpall të pavlefshme diplomën e SHML "Eçrem Çabej" në Prishtinë.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.


- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



U skladu s članom 8, članom 10 stav 2.2 i članom 15 Zakona br. 03/L-212 o radu objavljenom u Službenom listu Republike Kosovo dana 01.12.2010. godine, u vezi s članom 7 Uputstva Administrativnog broj 01/2024 o uređivanju postupaka konkursa u javnom sektoru koji je dio Zakona br. 03/L-212 o radu objavljenog u Službenom listu Republike Kosovo dana 31.10.2017. godine, i članom 8 stav 4, članom 11, članom 21 stav 2.2 i članom 25 Pravilnika br. 55/21 o radnom odnosu NPL „Përparimi“ Sh. A Sh. A. u Vuçitru, usvojenog dana 21.12.2021. godine od strane Upravnog odbora NPL „Përparimi“ Sh. A“ Sh. A., i uzimajući u obzir odluku sa brojem protokola 18/24 od 09.10.2024, godine od Izvršnog direktora, N.P.L. „Përparimi“ Sh. A. 10.10.2024 objavljuje:

JAVNI KONKURS

- I. **Naziv:** Fizičko osiguranje – čuvar
Broj izvršitelja: 1
Radno vrijeme: 40 sati sedmično
Trajanje imenovanja: Određeni period od jedne (1) godine, od kojih će šest (6) mjeseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja.
Stručna sprema: Srednja škola ili osnovna škola
Radno iskustvo: Poželjno šest (6) mjeseci
Izveštava: Rukovodilac Odsjeka za fizičko osiguranje
Visina mjesečne bruto plate: 390.00€.

Opis poslova i odgovornosti:

- Da bude sposoban da obavlja poslove radnog mjesta u punom radnom vremenu i bez ograničenja;
- Brine o osiguranju objekta i imovine organizacije, javne institucije;
- U slučaju opasnosti odmah obavještava nadležne osobe;
- Po potrebi može biti dodijeljen na drugu lokaciju radi fizičkog osiguranja;
- Obavezan je koristiti sve predviđene zaštitne mjere na poslu;
- Da bude sposoban koristiti protivpožarnu opremu;
- Odgovoran je rukovodiocu Odsjeka za fizičko osiguranje za obavljene posao;
- Obavlja i druge poslove po nalogu uprave preduzeća;

Posebni uslovi:

- Da bude državljanin Republike Kosovo;
- Fizička sposobnost, poželjno je da ima završene obuke iz oblasti sigurnosti;
- Poželjno je da ima licencu iz oblasti fizičkog osiguranja;

Uz prijavu treba dostaviti:

- Formular za prijavu N.P.L. „Përparimi“ Sh. A - Vuçitri.;
- Dokaz o stručnoj spremi (skenirano);
- Izvod iz matične knjige rođenih; (elektronski izdatnica na platformi e-Kosova će se prihvatiti)
- Potvrdu o nekažnjavanju izdatu od Stručnog vijeća Kosova, da nema krivičnih osuda u centralnom krivičnom registru Republike Kosovo (elektronski izdatnica na platformi e-Kosova će se prihvatiti);
- Dokaze o radnom iskustvu (skenirani) (nije obavezno);
- Kopiju lične karte (skenirano);

Opšti kriterijumi koje svi kandidati moraju ispuniti

- Budite državljanin Republike Kosovo.
- Imaju puni kapacitet za djelovanje.
- Da vlada najmanje jednim od službenih jezika u skladu sa Zakonom o jezicima.

Način vrednovanja kandidata.

- Pismeni test do sedamdeset (70) bodova.
- Usmeni intervju do dvadeset (20) bodova
- CV kandidata do deset (10) bodova.

Rok za prijavu kandidata i okvirni kalendar procedure zapošljavanja.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) kalendarskih dana od dana objavljivanja istog. Objava je otvorena od datuma 28.05.2024 do datuma 11.06.2024 u 16:00 sati.

Približni kalendar postupka regrutacije:

- Verifikacija unapred aplikacija kandidata najkasnije do 01.11.2024.
- Rok za prigovor od 04.11.2024 do 06.11.2024.

- Period kandidata kada će biti podvrgnuti pisanom testu, i kada će se vršiti njihova evaluacija, biće najkasnije do 19.11.2024.
- Rok za prigovor od 20.11.2024 do 22.11.2024.
- Period kandidata kada će biti podvrgnuti usmenom intervjuu, i kada će se vršiti njihova evaluacija, biće najkasnije do 02.12.2024.
- Rok za prigovor od 03.12.2024 do 05.12.2024.
- Objavlivanje konačnih rezultata u vezi sa uspešnim kandidatom biće najkasnije 10.12.2024.

Narativni kalendar postupka regrutacije može biti duži ili kraći, u zavisnosti od toga da li je podneta žalba ili ne, i u zavisnosti od rada ocenjivačke komisije i odeljenja za kadrove. U svim slučajevima kada se podnese žalba u bilo kojoj fazi postupka regrutacije, žalba će imati suspenzivni efekat dok se ista ne razmotri od strane Komisije za žalbe.

Kako se prijaviti i komunicirati sa kandidatima

Zainteresovani kandidati mogu dobiti prijavi formular u Arhivu NPL "Përparimi" Sh. A u gradu Vuçitru, ul. "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" br. 82, (bivša zgrada TMK kod Osnovnog suda u Mitrovici – ogranak u Vuçitru) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Kadrovska služba za sprovođenje člana 8 st. 3 Uputstva MFPT-br. 01/2024 za Uređenje konkursnih procedura u javnom sektoru, daće potrebna pojašnjenja za kandidate u vezi sa kriterijumima javnog konkursa, te pomoći i dati potrebna uputstva za prijavu putem elektronske adrese.

Podnošenje prijave sa svom dokumentacijom traženom u ovom javnom oglasu vrši se isključivo putem elektronske adrese i to: hrperparimi@gmail.com.

Sva komunikacija u toku postupka javnog nadmetanja odvijaće se putem elektronske komunikacije, a svaki od kandidata će biti pojedinačno obaviješten.

Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene.

ZAKLJUČAK

N.P.L. "Përparimi" Sh. A u Vuçitru nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Republike Kosovo, a nevećinske zajednice i njihovi pripadnici, osobe sa invaliditetom i nedovoljno zastupljeni pol se podstiču da se prijave.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



TRADITË QË NGA

1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

